

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6156
E mërkurë, 4 nëntor 2020
çmimi 0.40 €

Veseli kërkon nga qeveria t'i përkrahë punëtorët shëndetësorë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MINISTRJA E PUNËVE TË JASHTME DHE E DIASPORËS, MELIZA HARADINAJ-STUBLLA, ËSHTË TAKUAR TË MARTËN NË BERLIN ME MINISTRIN FEDERAL TË PUNËVE TË JASHTME TË GJERMANISË, HEIKO MAAS

FAQE 4-5

KOSOVA KËRKON PËRKRAHJEN E GJERMANISË PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka kërkuar nga homologu i saj gjerman, Heiko Maas, përkrahjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave. Gjatë vizitës në Berlin ajo ka thënë se marrëdhënia e fortë në mes të Kosovës dhe Gjermanisë është ndërtuar mbi vlerat e përbashkëta të lirisë, demokracisë dhe paqes së qëndrueshme. Ndërsa kryediplomati gjerman Heiko Maas nuk ka mundur të pretojë nëse çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën do të mund të kryhet gjatë presidencës gjermane të BE-së



OPINION

SFIDAT E SIGURISË, NË RITJE F. 11

Shkruan:
Ramadan
QEHAJA



AKTUALE

AVOKATI I POPULLIT: MUNGESA E STREHIMIT PËR QENTË ENDACAKË ËSHTË PROBLEM SERIOZ F. 6

VETËVENDOSJA E FTON PËR RAPORTIM PARA DEPUTETËVE MINISTRIN ZEMAJ F. 3

EKONOMI



DY PROJEKTILIGJE TË MPMS-së KALOJNË NË KOMISIONIN PËR EKONOMI DHE PUNËSIM F. 8

ZONA EKONOMIKE NË VUSHTRRI, BRENDA KËTIJ VITI E GATSHME PËR BIZNESE F. 8

KULTURË

NË 25-VJETORIN E TIJ TË VDEKJES, BOTOHET KOMPLETI I VEPRAVE TË ANTON ÇETTËS F. 6

AMERIKANËT VOTOJNË PËR PRESIDENTIN E ARDHSHËM

FAQE 2



Me përfundimin e një fushate të lodhshme dhe të ashpër presidenciale, me dhjetëra miliona votues u janë drejtuar të martën qendrave të votimit në të gjithë vendin për të vendosur nëse për katër vjetet e ardhshëm do ta mbajnë në detyrë presidentin republikan Donald Trump apo do ta zgjedhin rivalin e tij demokrat, ish-nënpresidentin Joe Biden

BOTA SOLIDARIZOHET ME AUSTRINË PAS SULMIT TERRORIST


FAQE 2



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI
www.kolegijibiznesi.com
info@kolegijibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Amerikanët votojnë për presidentin e ardhshëm

Me përfundimin e një fushate të lodhshme dhe të ashpër presidenciale, me dhjetëra miliona votues u janë drejtuar të martën qendrave të votimit në të gjithë vendin për të vendosur nëse për katër vjetët e ardhshëm do ta mbajnë në detyrë presidentin republikan Donald Trump apo do ta zgjedhin rivalin e tij demokrat, ish-nënpresidentin Joe Biden



WASHINGTON, 3 NËNTOR (ER) - Votuesit amerikanë u janë drejtuar kutive të votimit më 3 nëntor, për të vendosur nëse do t'ia japin edhe një tjetër mundësi presidentit amerikan Donald Trump, apo do ta dërgojnë sfiduesin e tij, demokratin Joe Biden, në Shtëpinë e Bardhë. Për më shumë, zgjedhjet po zhvillohen në kohën e pandemisë së koronavirusit, e cila ka ndikuar secilin hap të fushatës.

Kontrolli i Senatit, po ashtu, është në garë, ashtu sikurse ulëset në Dhomën e Përfaqësuesve. Një mori ndryshimesh të tjera ligjore do të hidhen në votim.

Votimet kanë nisur në pothuajse të gjitha shtetet e Bregut Lindor të ShBA-së, shumica e të cilave kanë hapur qendrat e votimit në orën 7:00 (13:00 me kohën evropiane).

Ky proces do të vazhdojë në tërë vendin që ka zona të ndryshme kohore, duke u dhënë qytetarëve më të drejtë vote rastin për të votuar, nëse nuk e kanë shfrytëzuar këtë të

drejtë në votimin e hershëm. Në këto zgjedhje të pazakonshme për shkak të pandemisë së koronavirusit, një numër rekord prej rreth 100 milionë amerikanëve tashmë kanë votuar përmes postës apo qendrave të votimit që janë hapur më parë, opSION ky i ofruar nga shumë shtete federale për ta parandaluar shpërndarjen e virusit vdekjeprurës.

Numri i lartë i votuesve dhe thirrjet për dalje masive në votime janë indikatorë se zgjedhjet e 2020-s mund të shënojnë pjesëmarrje shumë më të madhe sesa 55 për qind i vitit 2016.

Michael McDonald, profesor në Universitetin e Floridës, që e drejton projektin për zgjedhjet në ShBA, i tha "Radios Evropa e Lirë" se parashikimi për pjesëmarrje në këto zgjedhje është rreth 160 milionë, apo 67 për qind e trupit elektoral, që është shkalla më e lartë që nga viti 1950.

Ashtu edhe si vëzhguesit e tjerë, McDonald, thotë se do të

mund të marrë kohë derisa të dihen rezultatet, ndryshe prej herëve të tjera presidenciale kur njëri nga kandidatët shpall fitoren pasi arrin 270 votat elektorale, gjë e cila zakonisht bëhet e ditur në natën e zgjedhjeve. Kjo për shkak se do të marrë kohë numërimi i votave me postë dhe disa shtete, duke përfshirë këtu edhe Pensilvaninë me 20 vota elektorale, nuk mund ta nisin numërimin e këtyre votave deri në ditën e zgjedhjeve.

Sondazhet e opinionit publik e nxjerrin Bidenin përpara Trumpit në nivel kombëtar me së paku 8 për qind, por ai ka një avantazh më të ngushtë në disa shtete, që potencialisht i japin Trumpit votat e nevojshme për ta fituar Kolegjin Zgjedhor, i cili e përcakton fituesin.

PSE EKZISTON KOLEGJI ELEKTORAL?

Të 538 anëtarët e Kolegjit Elektoral në Shtetet e Bashkuara mbledhen në kryeqytetet e tyre respektive çdo katër vjet, pas mbajtjes së zgjedhjeve, ashtu që ta shpallin fituesin. Një kandidat presidencial duhet të fitojë një shumicë absolute të votës së Kolegjit apo 270 vota nga 538 për të fituar.

Ky sistem është krijuar bashkë me Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara më 1787.

Krijuesit e shtetit amerikan e kanë konsideruar këtë sistem si kompromis në mes të të zgjedhurit të presidentit në mënyrë direkte dhe të zgjedhurit përmes anëtarëve të Kongresit, qasje që janë refuzuar dhe janë konsideruar jomjaftueshëm demokratike. Që atëherë, qindra amendamente janë propozuar në Kongres, me qëllim të ndryshimit apo zhbërjes së Kolegjit Elektoral, mirëpo asnjëra nuk ka rezultuar me sukses.

Pasi shtetet t'i verifikojnë rezultatet e tyre, zgjedhësit e Kolegjit Zgjedhor do të mbledhen më 14 dhjetor, në shtetet e tyre përkatëse për të hedhur votën për president dhe atë për zëvendës-president. Këto rezultate dorëzohen më pas në Capitol, ku më 6 janar 2021 Senati dhe Dhoma e Përfaqësuesve do të takohen për një seancë të përbashkët për t'i numëruar votat elektorale. Kur të numërohen votat dhe kandidati ta ketë marrë shumicën prej 270 votave ose më shumë vota elektorale, nënkryetari i cili kryeson në Senat do t'i shpallë rezultatet.

Bota solidarizohet me Austrinë pas sulmit terrorist


VJENË, 3 NËNTOR - Katër civilë janë vrarë dhe 22 janë plagosur gjatë sulmit të së hënës në Vjenë, të cilin autoritetet austriake e kanë cilësuar "terrorist".

Policia austriake vrau sulmuesin, që e identifikuan si Kujtim Fejzullai, 20 vjeç, me shtetësi të Austrisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Autoritetet maqedonase konfirmuan të martën se edhe dy shtetas të tjerë maqedonas kanë qenë të përfshirë në sulmin në Vjenë.

Ministri i Brendshëm austriak, Karl Nehammer, tha se 14 persona janë arrestuar në lidhje me sulmin në Vjenë. Ai shtoi se pas bastisjes së shtëpisë së sulmuesit, tashmë të vrarë, janë kryer edhe 18 bastisje.

Ministri i Brendshëm austriak tha se, bazuar në të dhënat, nuk ka indikacione se edhe një sulmues i dytë ka qenë i përfshirë në sulmin në Vjenë. Ai, po ashtu, shtoi se sulmuesi në



Vjenë dukej se ishte integruar në shoqërinë austriake por, në fakt, ishte e kundërta. Sipas Nehammer: "Ai arriti t'i mashtronte njerëzit brenda programit të derakalizimit dhe përmes kësaj të lirohej nga burgju".

Qeveria austriake ka shpallur tri ditë zie.

Kancelari austriak Sebastian Kurz e quajti atë një "sulm të

neveritshëm terrorist".

Ai të martën tha se është i vetëdijshëm se kjo nuk është një "mosmarrëveshje midis të krishterëve dhe myslimanëve". "Ne gjithmonë duhet të jemi të vetëdijshëm se kjo nuk është një mosmarrëveshje midis të krishterëve dhe myslimanëve ose midis austriakëve dhe migrantëve. Kjo është një luftë midis shumë njerëzve që

besojnë në paqe dhe atyre pak që duan luftë", ka thënë Kurz.

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dënoi sulmin në Vjenë, duke thënë se akte të tilla "ndaj njerëzve të pafajshëm" duhet të ndalen. "Lutjet tona janë me njerëzit në Vjenë pas edhe një akti të terrorizmit në Evropë. Këto sulme djallëzore kundër njerëzve të pafajshëm duhet të ndalen. ShBA-ja qëndron me Austrinë, Francën dhe me gjithë Evropën në luftën kundër terroristëve, përfshirë edhe terroristët radikalë islamikë", ka shkruar Trumpi në "Twitter".

Kancelarja gjermane Angela Merkel të martën tha se "terrori islamik është armiku ynë i përbashkët". Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha se "Evropa është e bashkuar dhe e vendosur. Ne jemi një".

Edhe Turqia ka dënuar sulmin në Vjenë, duke thënë se qëndron në solidaritet me

popullin austriak. "Ne jemi të pikëlluar me lajmin se ka të vdekur dhe të plagosur si rezultat i sulmit terrorist që ndodhi në Vjenë", ka pohuar ministria e Jashtme turke në një deklaratë për media.

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu dënoi sulmin në Vjenë duke thënë se "Izraeli dënon sulmin brutal në Vjenë dhe qëndron në solidaritet me Austrinë. Popujt e civilizuar kudo duhet të bashkohen për ta mposhtur egërsinë e terrorizmit islamik të ringjallur", ka theksuar ai.

Edhe presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, përmes një postimi në "Twitter" ka theksuar se sulmi terrorist në Vjenë është sulm "ndaj vlerave që ne ndajmë". "Ky moment i vështirë do të na afrojë më shumë në luftën kundër terrorizmit", ka shkruar Thaçi, duke shtuar se Kosova qëndron përkrah popullit dhe shtetit austriak.

Konstituohet Komisioni i përbashkët Parlamentar për Stabilizim Asociim BE-Kosovë

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Në Kuvendin e Kosovës të martën është mbajtur mbledhja konstituive e Komisionit të përbashkët Parlamentar për Stabilizim Asociim BE-Kosovë për Legjislaturën VII.

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Marrëveshja për Stabilizim Asociim synon që t'i rregullojë marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe BE-së që nga dita e nënshkrimit të saj e deri te dita e anëtarësimit të plotë në BE.

Duke konsideruar se agjenda e reformës së Kosovës në Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit është gjithëpërfshirëse, që mbulon fushat nga dialogu politik e deri te bashkëpunimi rajonal, kryetarja Osmani ka potencuar se në thelb të MSA-së qëndrojnë aspektet ekonomike për të cilat Kosova merr një mori obligimesh për

reforma, në drejtim të vendosjes së një ekonomie funksionale të tregut.

Ndër të tjerë, kryeparlamentarja Osmani ka shpalosur edhe përbërjen e komisionit të përbashkët për MSA-në, të përbërë nga 13 deputetë dhe nga anëtarët e tjerë të Parlamentit Evropian. Po ashtu, ajo bëri me dije se deputeti nga radhët e LDK-së, Arben Gashi, do të jetë kryesues i këtij Komisioni nga Kuvendi i Kosovës.

Në përmbyllje të fjalimit të saj, ajo ka ftuar anëtarët e këtij komisioni që t'i japin rëndësi zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim dhe avancimit të agjendës së integritimit evropian, pasi janë indikatorë të fuqishëm në suksesin të Kosovës si shtet.

Kryesuesi i komisionit, Arben Gashi, ka shpalosur mënyrën e funksionimit të këtij komisioni, duke treguar se ky komisioni punon në bazë të rregullores së tij dhe që takimet mbahen dy herë në



vit, ku njëra nga mbledhjet mbahet në Kosovë dhe tjetra në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian. Ai, po ashtu, para anëtarëve të tjerë të komisionit ka treguar se nga Qeveria e Kosovës ka

ardhur plani kombëtar për MSA-në dhe që së shpejti ky komision do të takohet për ta parë dhe shqyrtuar këtë plan. Ndërkaq deputeti Enver Hoxhaj, njëherësh anëtar i Komisionit për MSA-në, ka

propozuar që të ketë koordinim edhe me listën e miqve evropianë të komisionit të përbashkët, të cilët mund të jenë në shërbim të Kosovës për të çuar përpara çështje me rëndësi për vendin.

Veseli kërkon nga qeveria t'i përkrahë punëtorët shëndetësorë

PRISHTINË, 3 NËNTOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ka vizituar të martën Odën e Mjekëve, ku është takuar me kryetarin Pleurat Sejdiu dhe kryetarin e Federatës Sindikale të Shëndetësisë, Blerim Sylja.

Veseli ka kërkuar paga më dinjitoze për punonjësit shëndetësorë duke bërë thirrje që Ligji për Paga të rikthehet në Kuvend për amendamentim në përputhje me rekomandimet e Gjykatës Kushtetuese. "Qëllimi i vizitës time është për falënderim për të gjithë mjekët dhe punëtorët shëndetësorë për punën e tyre të jashtëzakonshme që janë duke e bërë. Kemi shumë obligim që si politikë të qëndrojmë afër tyre dhe t'i ndihmojmë. Si parti opozitare



do ta përkrahim çdo iniciativë të qeverisë, në veçanti amendamentimin e Ligjit për Paga që mund ta bëjmë brenda një jave. Në këtë mënyrë ne mund të jemi

pranë punëtorëve shëndetësorë. Këta po e bëjnë punën e tyre dhe ne duhet ta bëjmë tonën. Unë sot isha për ngushëllime te një tjetër mjek, ish-bashkëluftëtar i imi, dr.

Safet Idrizi, i cili dikur e fitoi luftën me Serbinë, por sot e ka humbur betejën me Covidin. Sikurse u ka shërbyer atëherë njerëzve, ai ka qenë në krye të frontit edhe këto ditë si mjek.

Fakti që nëntë mjekë kanë humbur jetën me këtë sëmundje dhe rreth 1 300 punëtorë shëndetësorë janë infektuar, flet për nevojën e madhe që ata kanë për mbështetje", ka thënë Veseli.

Edhe kryetari i Odës së Mjekëve, Pleurat Sejdiu dhe ai i Federatës Sindikale, Blerim Sylja, e kanë falënderuar për vizitën liderin e PDK-së, duke e përgëzuar për qasjen dhe interesimin, në veçanti për mbështetjen e PDK-së që të rikthehet sa më parë në Kuvendin e Kosovës Ligji për Paga.

Kryetari Veseli gjatë ditës ka takuar edhe studentët e Fakultetit të Mjekësisë, të cilëve u ka kërkuar të qëndrojnë në Kosovë pas studimeve dhe të kontribuojnë për vendin.

Vetëvendosja e fton për raportim para deputetëve ministrin Zemaj



PRISHTINË, 3 NËNTOR (ER) - Lëvizja Vetëvendosje përmes nënkryetares së saj të Kuvendit, Arbërie Nagavci, i ka dërguar kërkesë Kryesisë së Kuvendit, që të ftohet Armend Zemaj për raportim para deputetëve për situatën me Covid-19 në Kosovë.

LV-ja ka theksuar se gjendja

pandemike në vend është përkeqësuar në mënyrë drastike. "Pavarësisht prej përpjekjes vetëmohuese dhe përkushtimit të punonjësve shëndetësorë, numri i madh i të infektuarve, spitalet e mbingarkuara dhe paaftësia e kësaj qeverie po e bëjnë përballjen me Covid-19 tre-

fishë më të rëndë për qytetarët e Kosovës. Gjatë javës së fundit janë regjistruar rreth 2 500 raste të reja, kurse betejën me këtë virus e kanë humbur mbi 30 qytetarë. Këto shifra janë alarmante. Kjo është shenjë se Kosova po shkon drejt thellimit të krizës. Ndonëse ministri kishte

premtuar spital të veçantë për Covid-19, realizimi i tij nuk duket gjëkund, e Klinika e Pulmologjisë dhe spitalet rajonale nuk kanë kapacitet për trajtim të një vale të re të të prekurve. Qytetarët e Republikës ndodhën pa mbështetje dhe pa përkujdesje", ka njoftuar LV-ja.



Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, është takuar të martën në Berlin me ministrin Federal të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Heiko Maas

KOSOVA KËRKON PËRKRAHJEN E GJERMANISË PËR LIBERALIZIMIN E VIZAVE

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka kërkuar nga homologu i saj gjerman, Heiko Maas, përkrahjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave. Gjatë vizitës në Berlin ajo ka thënë se marrëdhënia e fortë në mes të Kosovës dhe Gjermanisë është ndërtuar mbi vlerat e përbashkëta të lirisë, demokracisë dhe paqes së qëndrueshme. Ndërsa kryediplomati gjerman Heiko Maas nuk ka mundur të pretojë nëse çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën do të mund të kryhet gjatë presidencës gjermane të BE-së

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, ka takuar të martën në Berlin ministrin Federal të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Heiko Maas, ku kanë diskutuar për proceset që po kalon Kosova. Me këtë rast, ajo ka kërkuar përkrahjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave për Kosovën. Në konferencën e përbashkët për media, kryediplomatja e Kosovës ka thënë se marrëdhëniet e fortë në mes të Kosovës dhe Gjermanisë janë ndërtuar mbi vlerat e përbashkëta të lirisë,

demokracisë dhe paqes së qëndrueshme. Sipas saj, Berlioni mbetet kryeqyteti ynë kryesor evropian dhe shtet aleat për Kosovën dhe popullin e saj. "Marrëdhënia e fortë në mes të Kosovës dhe Gjermanisë është ndërtuar mbi vlerat e përbashkëta të lirisë, demokracisë dhe paqes së qëndrueshme. I shpreha ministrin Maas mirënjohjen e thellë për ndihmën e qeverisë gjermane dhënë Kosovës gjatë pandemisë dhe përkrahjen e palëkundur për vendosjen në agjendë të liberalizimit të vizave gjatë Presidencës Gjermane të Këshillit të BE-së", ka thënë Haradinaj-Stublla.

Ajo ka treguar se në këtë takim kanë diskutuar mbi gjendjen e

shkëlqyeshme të marrëdhënieve dypalëshe, duke u pajtuar për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit. "Diskutuar mbi gjendjen e shkëlqyeshme të marrëdhënieve tona dypalëshe dhe u pajtuam për thellim të mëtejshëm të bashkëpunimit në fusha të interesit të përbashkët politik dhe ekonomik, po ashtu edhe për përfundimin e njohjes së patentshoferëve", ka deklaruar ajo. Ajo ka dënuar edhe një herë sulmin terrorist në Vjenë. "Tre policë që u angazhuan në aksionin e mbrëmshëm janë me prejardhje shqiptare. Ata ndihmuan austriakët që t'i mbrojnë vlerat e tyre themelore të cilat ne i ndajmë me popullin e Austrisë", ka deklaruar ajo.

Kryediplomatja Haradinaj-Stublla ka deklaruar se Kosova është kundër terrorizimit. "Kjo tregon se sa mirë janë të integruar shqiptarët. Kosova qëndron fort kundër terrorizmit dhe ne jemi pjesë e koalicionit botëror në luftë kundër ISIS-it", ka deklaruar Haradinaj-Stublla. Ndërsa shefi i diplomacisë gjermane, Heiko Maas, ka folur për pritshmëritë që janë në Prishtinë për procesin e liberalizimit të vizave. Maas ka thënë se po punojnë për këtë drejtim, por nuk ka premtuar se kjo çështje do të hyjë në rend të ditës pasi që Gjermania e mban presidencën e BE-së deri më 31 dhjetor.

Kryediplomatët e të dy vendeve kanë folur edhe për procesin e

dialogut për normalizmin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, i cili lehtësohet nga BE-ja. Ministri Maas ka shprehur vendosmërinë që roli i Gjermanisë në dialogun Kosovë - Serbi të vazhdojë të jetë aktiv dhe mbështetës në arritjen e marrëveshjes gjithëpërfshirëse ligjrisht të obligueshme në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Ndërsa Haradinaj-Stublla ka nënvizuar nevojën urgjente të definimit të dialogut në tri elemente kyçe: kohëzgjatjen, parimet dhe objektivin final e cila domosdoshëm duhet të rezultojë me njohje reciproke.

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla, gjatë vizitës së saj në Berlin ka takuar edhe

të Brendshme të Gjermanisë, Stephan Mayer, shpreha falënderimin e Kosovës ndaj shtetit gjerman, dhe ministrit federal Horst Seehofer për ndihmën e pandërprerë dhe bashkëpunimin për forcimin e pozicionit të Kosovës drejt epilogut pozitiv për lëvizje të lirë në BE”, ka thënë Haradinaj Stublla.

Kryediplomatja ka theksuar se Kosova ka pritje të larta nga presidenca e Gjermanisë për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën. “Theksova që Kosova ka pritje të larta nga presidenca gjermane që agjenda e liberalizimit të vizave për Kosovën të futet në agjendë këtë muaj. Z. Mayer, gjithashtu, e informova që Kosova tashmë ka filluar punën edhe me Francën dhe Holandën që sipas modelit gjerman të bashkëpunimit në nivel ekspertësh, të përmbyllim këtë proces pozitivisht”, është shprehur Haradinaj-Stublla.

Shefja e diplomacisë ka theksuar se nga Mayer ka marrë mbështetjen për bashkëpunim dhe shkëmbim të përvojave. “Nga z. Mayer u sigurova që Ministria Federale e Punëve të Brendshme do të mbështesë më tej Kosovën duke ndarë përvojën pozitive të bashkëpunimit me Kosovën dhe me shtetet skeptike, në mënyrë që të përmbyllet me sukses vendimmarrja e liberalizimit të vizave. Sekretari Mayer shprehu mirënjohjen për përparimin e Kosovës për përmbushjen e kriterëve dhe se Gjermania do të jetë gjithnjë një shtet partner dhe mik për vendin tonë”, ka përfunduar Haradinaj-Stublla.

Edhe tetë viktima dhe 334 të infektuar me Covid në Kosovë



AMBULANCA PËR CORONAVIRUS

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar të martën 334 raste të reja me Covid-19, pas marrjes së 1 621 mostrave.

Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKShPK) ka njoftuar se brenda 24 orëve janë regjistruar tetë viktima.

Sipas të dhënave të këtij Instituti, të martën janë regjistruar edhe 81 raste që kanë mposhtur virusin, kurse raste aktive aktualisht janë 4 562.

Prej 13 marsit, kur janë regjistruar rastet e para me koronavirus në Kosovë, autoritetet shëndetësore

kanë raportuar për 20 989 të prekur nga sëmundja Covid-19, që shkakton koronavirusi. Prej këtyre, 705 pacientë kanë vdekur.

Më 1 nëntor Qeveria e Kosovës ka miratuar kufizimet e reja, me qëllim të frenimit të sëmundjes Covid-19 që shkakton koronavirusi.

sekretarin parlamentar të Shtetit në Ministrinë Federale të Punëve të Brendshme të Gjermanisë, Stephan Mayer. Shefja e diplomacisë e ka falënderuar sekretarin Mayer për mbështetjen e shtetit gjerman karshi Kosovës. “Në takim me Sekretarin Parlamentar të Shtetit në Ministrinë Federale të Punëve

Naim Fetahu fton prokurorinë t'i hetojë keqpërdorimet në Komunën e Podujevës

PODUJEVË, 3 NËNTOR (ER) - Kryetari i Degës së PDK-së në Podujevë, njëkohësisht kandidat për kryetar të kësaj komune, Naim Fetahu, në një konferencë për media ka denoncuar abuzimet dhe keqpërdorimet e buxhetit në Komunën e Podujevës.

Gjatë kësaj konference Fetahu ka përmendur një sërë skandalesh dhe shkeljesh që ushtruesi i detyrës së kryetarit, Nexhmi Rudari, ka bërë në këtë komunë. Me këtë rast, Fetahu ka ftuar prokurorinë e shtetit që urgjentisht t'i hetojë këto skandale që po ndodhin këtu. “Komuna e Podujevës për riparimin e rrugëve të asfaltuara kishte lidhur kontratë kornizë më 28.06.2018 me afat deri më 28.10.2019. Edhe pse kjo kontratë kishte skaduar, komuna kishte vazhduar porositjen e shërbimeve, duke tejkaluar dy pozicione në vlerë 4,477 euro”, ka thënë Fetahu.



Më tej, ai ka përmendur edhe disa shkelje të tjera. “Me të gjitha këto shkelje, të cilat i ka vërtetu-

ar edhe raporti i auditorit, Nexhmi Rudari vetëm ka vazhduar një qeverisje të keqe 20-

vjeçare të LDK-së. Për më tepër, ai ka dëshmuar se nuk është i gatshëm dhe as i kualifikuar për

ta udhëhequr komunën”, ka thënë Fetahu.

Në fund, kandidati për kryetar të Podujevës, Naim Fetahu, i ka bërë thirrje prokurorisë që t'i hetojë të gjitha keqpërdorimet e buxhetit të komunës që janë bërë muajt e fundit. “Ftoj urgjentisht edhe prokurorinë e shtetit që t'i nisë hetimet në lidhje me abuzimet e buxhetit që janë bërë në komunën tonë, përfshirë ato gjatë periudhës së rëndë me pandeminë”, ka thënë Fetahu.

Asambleti i PDK-së në Komunën e Podujevës, Rafet Llapashtica, ka përmendur disa prej shkeljeve që ka bërë Komuna e Podujevës. “Një palë doreza të thjeshta komuna i ka blerë 14 euro, ndërsa një palë rroba njëpërdorimëshe 28 euro. Po ashtu, autoambulancën që komunat e tjera e kanë paguar 33 mijë euro, Komuna e Podujevës e ka blerë 60 mijë euro”, ka thënë Llapashtica.

Në 25-vjetorin e tij të vdekjes, botohet kompleti i veprave të Anton Çettës

PRISHTINË, 3 NËNTOR (ER) - Të martën u bënë 25 vjet që prej kur është ndarë nga jeta atdhetari, patrioti, mbledhësi i folklorit Anton Çetta. Për nder të figurës së tij, me propozim të Ministres së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, Qeveria e Kosovës ka marrë vendim që muaji nëntor të jetë muaji i Anton Çettës.

Në kuadër të këtij muaji janë planifikuar të organizohen një sërë aktivitetesh në nderim dhe kujtim të kësaj figure të ndritshme të Kosovës, por për shkaqe pandemie shumë nga organizimet do të mbahen në mënyrë online ose me sa më pak njerëz të grumbulluar për t'i respektuar rekomandimet e institucioneve shëndetësore.

Aktivitetet kanë nisur nga dita e martë me botimin e kompletit të veprave të Anton Çettës, të cilat i prezantoi ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, në një takim me ministrën e Financave, Hykmete Bajrami.

Ndonëse të martën parashihej që të bëhej edhe promovimi i kompletit të veprave, mirëpo për shkak të rrethanave me Covid-19, organizimi i një promovimi të tillë ishte i

pamundur.


Kompleti i veprave të Çettës përmban 13 vëllime, duke përfshirë krijimet për fëmijë, përmbledhjen e folklorit në 5 vëllime, kërkimet folklorike, balada dhe legjenda, këngë kreshnike, varia, të tjerët për veprën e Anton Çettës janë përmbledhur në një vëllim, Anton Çetta dhe aksioni i pajtimin të gjaqeve dhe vëllimi i fundit intervista dhe letërkëmbime.

Botimi i kompletit është mbështetur nga MKRS-ja dhe nga Qeveria e Kosovës.

Ministrja Dumoshi ka falënderuar ministrën Hykmete Bajrami për mbështetjen që i ka dhënë këtij botimi, përmes Ministrisë së Arsimit, si ish-ministre e Arsimit.

Ministret Dumoshi dhe Bajrami e vlerësuan lart figurën e Çettës dhe u shprehën se përmes këtyre aktiviteteve Qeveria e Kosovës e nderon dhe e çmon figurën e tij.

Në përvjetorin e Anton Çettës, ministrja Dumoshi dhe Bajrami janë bërë homazhe te varri i tij në Prizren, së bashku me profesor Rizah Krasniqin, si rikujtim dhe përlulje për angazhimin dhe kontributin e



tij të jashtëzakonshëm për pajtimin e mijëra familjeve të hasmuara dhe për çrrënjësien e dukurisë së keqe të gjakmarrjes. "Aksioni për pajtimin e gjaqeve

bëri që viti 1990 të futej në histori si viti kur kjo plagë do të zhdukej rrënjësisht. Si institucione të shtetit të Kosovës e kemi për obligim dhe detyrim

që historinë e Kosovës ta kujtojmë dhe nderojmë brenda të gjithë mekanizmave institucionalë që kemi", ka thënë ministrja Dumoshi.

Avokati i Popullit: Mungesa e strehimit për qentë endacakë është problem serioz

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Avokati i Popullit ka publikuar raportin me rekomandime Ex-officio në lidhje me rrezikun që u kanoset qytetarëve nga qentë endacakë. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së institucioneve shtetërore për trajtimin dhe ndërmarrjen e masave përkatëse lidhur me rrezikun nga qentë endacakë ndaj qytetarëve, në veçanti ndaj fëmijëve, përkritazi me mbrojtjen e jetës dhe sigurinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare. "Pas rishikimit të legjislacionit përkatës, të instrumenteve ndërkombëtare, të dokumentacionit të çështjes si



dhe të të dhënave të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit i ka në dispozicion, rezultoi se në rastin konkret ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, përkatësisht të të drejtave të fëmijëve, pasi

institucionet përkatëse nuk i kanë përmbushur detyrimet kushtetuese, ligjore e as standardet ndërkombëtare, të zbatueshme në Republikën e Kosovës, në ndërmarrjen e të gjitha masave për mbrojtjen e

qytetarëve nga rreziku që u kanoset nga qentë endacakë", thuhet në njoftimin për media. Avokati i Popullit vëren se, pavarësisht prej përpjekjeve të disa komunave për t'u përballur me çështjen e trajtimin të qenve

endacakë, gjendja nuk ka ndryshuar shumë për shkak të mungesës së një plani kombëtar dhe të moskoordinimit ndërkomunal dhe ndërinstucional që do ta adresonte atë. "Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e strehimit për qentë endacakë është problem serioz në nivel vendi dhe komunat nuk kanë qendër për trajtim të përkohshëm të kafshëve si dhe nuk kanë siguruar një vend të veçantë për hedhjen e sigurt të kafshëve të ngordhura, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 04/2017. Raporti jep rekomandime specifike dhe konkrete për veprimet që duhet t'i ndërmarrin institucionet përkatëse shtetërore lidhur me çështjen", thuhet më tej në njoftim.

Bordi i RTK-së kompletton menaxhmentin e transmetuesit publik

PRISHTINË, 3 NËNTOR (ER) - Pas një procesi të hapur dhe transparent, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të RTK-së, Ngadhjnim Kastrati, bordi i RTK-së ka emëruar dy

zëvendës drejtorët e përgjithshëm, drejtorin e Televizionit, drejtorin e kanalit në gjuhën serbe dhe drejtorin e Radios. Zëvendës drejtorët të përgjithshëm u emëruan

Mentor Shala dhe Lorik Arifaj. Drejtor i televizionit u emërua Festim Kabashi, drejtor i kanalit në gjuhën serbe u emërua Zhelko Tvrdishi dhe drejtor i Radios u emërua Ernest

Luma. Me këto emërimet u kompletua menaxhmenti i RTK-së, i cili, për shkak të mungesës së anëtarëve të bordit, nuk kishte arritur të kompletohej deri më tash.



MPJ: Armatosja e Serbisë nga Rusia, kërcënim serioz për stabilitetin rajonal

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) ka theksuar se armatosja e Serbisë nga Rusia paraqet “kërcënim të qartë për tërë rajonin”, duke bërë thirrje që këto veprime të Serbisë të dënohen. Sipas kësaj ministrie, edhe pse Serbia mëton se dëshiron të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, ajo në vazhdimësi është duke luajtur një rol krejtësisht të kundërt, duke zhvilluar stërvitje të përbashkëta ushtarake me Rusinë dhe Bjellorusinë



EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) përmes një reagimi ka theksuar se ka përcjellë me shqetësim deklaraten e ministrit të ri serb të Mbrojtjes, i cili ka deklaruar se “tridhjetë tanke T-72 do të arrijnë në Serbi si pjesë e marrëveshjes Vuçiq-Putin, të arritur në Soçi”. “Armatosja e vazhdueshme e Serbisë nga ana e Rusisë është kërcënim i qartë për të gjithë rajonin, duke e ditur të kaluarën e rëndë kriminale të Serbisë dhe përpjekjet për ta vazhduar politikën e saj të shekullit të kaluar prej agresori në Ballkanin Perëndimor. Ky armatim i radhës i Serbisë vjen menjëherë pasi që Rusia njoftoi hapjen e një zyre të saj në

Ministrinë e Mbrojtjes së Serbisë, në përpjekje për t'i thelluar lidhjet ushtarake dhe koordinimin e plotë ushtarako-teknik në mes të dy vendeve”, është thënë në reagimin e Ministrisë së Jashtme dhe Diasporës.

Sipas kësaj ministrie, edhe pse deklarativisht Serbia mëton se dëshiron të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian, ajo në vazhdimësi është duke luajtur një rol krejtësisht të kundërt, duke zhvilluar stërvitje të përbashkëta ushtarake me Rusinë dhe Bjellorusinë, madje është raportuar për pjesëmarrjen e forcave të rregullta ushtarake serbe (përfshirë snajperistë) në Bjellorusi. “Ushtarët e Serbisë janë parë të përfshirë aktivisht edhe në konfliktin në Ukrainë dhe ka njoftime për përfshirje të

mundshme të tyre edhe në konfliktin Azerbajxhan - Armeni”, theksohet në këtë reagim.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka vlerësuar se prania e NATO-s në Kosovë dhe anëtarësimi i shteteve të rajonit në këtë organizatë, i kanë kontribuar sigurisë, paqes dhe stabilitetit rajonal. “Serbisë dhe Rusisë nuk u konvenojnë stabiliteti, siguria dhe paqja në rajon. Prandaj, e gjithë kjo sjellje destruktive dhe e rrezikshme e Serbisë duhet të dënohet dhe të parandalohet para se të bëhet

shumë vonë. Përderisa Serbia duket se është përcaktuar që të bëhet një hambar ushtarak rus, Kosova dhe vendet e tjera të rajonit tonë janë përcaktuar për vlerat e vendeve të civilizuara dhe demokratike. Anëtarësimet euro-atlantike të të gjitha shteteve tona janë përgjigjja më e mirë ndaj tendencave të këtyre vendeve që po përpiqen ta destabilizojnë rajonin tonë dhe ta kërcënojnë në vazhdimësi paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Ballkan”, thuhet në reagimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Beogradi zyrtar ka njoftuar të

hënën se 30 tanke të tipit Tanke T-72 do të arrijnë në Serbi.

Mediat kanë raportuar se tanket e para nga donacioni rus kanë arritur në Serbi më 28 tetor. Donacioni është pjesë e një marrëveshjeje që presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka arritur me ministrin rus të Mbrojtjes, Sergei Shoigu, në vitin 2016. Marrëveshja më pas është miratuar nga presidenti rus Vladimir Putin.

Donacioni përfshin edhe gjashtë aeroplanë luftarakë MiG-29 dhe 30 automjete të blinduara zbulimi BRDM-2.

Blerta Deliu dhe bashkëshorti i saj i nfektohen me Covid-19

PRISHTINË, 3 NËNTOR (ER) - Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës, Blerta Deliu, është infektuar me Covid-19. Lajmin e ka dhënë vetë ajo përmes një postimi në “Facebook”. Deliu ka thënë se me Covid-19 është infektuar edhe bashkëshorti i saj. “Pas shfaqjes së disa simptomave kemi konsultuar mjekët dhe i jemi nënshtruar testit për Covid-19, me ç'rast unë dhe bashkëshorti kemi rezultuar pozitivë. Sapo morëm rezultatet, u vetizoluam dhe do t'iu nën-

shtrohemi këshillave mjekësore derisa ta kalojmë këtë gjendje. U kërkoj ndjesë kolegëve dhe aktivistëve të partisë që më duhet t'i ndërpres takimet dhe bashkëbisedimet me anëtarët, simpatizantët dhe qytetarët në përgjithësi, gjatë kampanjës që kemi filluar kohë më parë. Lutem që kjo valë e infeksionit me virusin të kalojë sa më shpejt dhe ju lus të vazhdoni t'i mbani maskat, të kujdeseni për higjienën dhe ta ruani distancën”, ka shkruar Deliu.



Hoti për vizitë zyrtare në shtetin e Vatikanit dhe në Republikën e Italisë




PRISHTINË, 3 NËNTOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka udhëtuar të martën për vizitë zyrtare në Shtetin e Vatikanit dhe në Republikën e Italisë. Sot (e mërkurë) paradite

kryeministri Hoti do të pritë në takim nga Sekretari i Shtetit të Vatikanit, Kardinali Pietro Paroli, në Logjën e parë të Pallatit Apostolik, raporton “Epoka e re”. Ndërsa pasdite në ambientet e qeverisë

italiane do të zhvillojë një takim me homologun e tij Giuseppe Conte. Në vizitën e parë zyrtare të kryeministrit Hoti, në shtetin e Vatikanit dhe në Republikën e Italisë, ai shoqërohet nga

zëvendëskryeministri Diton Selmanaj, ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Meliza Haradinaj-Stublla dhe zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Teuta Sahatqiu.

Tahiri: Do ta mbështesim sektorin e teknologjisë informative dhe të inovacionit



Prishtinë, 3 nëntor (ER) - Zëvendëskryeministri Besnik Tahiri ka vizituar të martën Innovation Centre Kosovo (ICK), me ç'rast ka thënë se ka pasur nderin që ta vizitojë këtë institucion të veçantë në Republikën e Kosovës, siç është ICK, e cila udhëhiqet nga Uranik Begu. "Është krenari dhe mburrje

të shohim se si ka arritur ky institucion të etablohet në institucionet më të rëndësishme globale dhe që të marrë çmime më të larta të inovacionit dhe teknologjisë në nivel bote. Nga vizita që i bëra, u mahnita me punën e tij dhe çmimin që e ka fituar Uraniku me ICK-në në Kolumbi. Megjithatë, ajo çka na

bën shumë të kënaqur është se Uraniku me ICK-në, e ka vendosur Kosovën në 20 vendet më të rëndësishme për teknologjinë në kohë pandemie", është shprehur zëvendëskryeministri Tahiri.

Më tej, zëvendëskryeministri Tahiri theksoi se meqenëse jemi në kohë pandemie, komunikimi

online dhe inovacionet që lidhen me teknologjinë informative janë çelësi dhe imperativ i kohës dhe këtë nuk duhet ta trajtojmë më si luks, por pjesë e jetës sonë të përditshme. Andaj, siç u shpreh ai, kjo do të jetë pjesë e jetës sonë të vazhdueshme, aq sa kemi jetëgjatësi në punë, biznes, qeveri, në menaxhim publik dhe

në ofrimin e shërbimeve.

Duke përgëzuar për punën e bërë, zëvendëskryeministri Tahiri ka shprehur zotimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës në mbështetje të sektorit të teknologjisë informative, në këtë rast ICK-së dhe në përgjithësi sektorit privat, për t'i kaluar sfidat me të cilat ballafaqohen bizneset.

Zona ekonomike në Vushtrri, brenda këtij viti e gatshme për biznese



EPOKA E RE

A. MAVRAJ

VUSHTRRI, 3 NËNTOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Vesel Krasniqi, ka vizituar Komunën e Vushtrrisë, ku është pritur nga kryetari i kësaj komune, Xhafer Tahiri. Pas bisedave në komunë, ministri Krasniqi, bashkë me kryetarin Tahiri, kanë vizituar Zonën Ekonomike në këtë komunë për ta parë nga afër dinamikën e punimeve që janë

duke u bërë në këtë zonë.

Ministri Krasniqi ka thënë se Zona Ekonomike në Vushtrri do të jetë mundësi e mirë për bizneset, duke u zotuar se punët e mbetura do të finalizohen në fund të nëntorit. "Jemi në një Zonë Ekonomike, që Vushtrrisë do t'i ofrojë shumë mundësi të mira, në veçanti bizneseve të cilat janë të interesuara të prodhojnë. Besoj se deri në fund të nëntorit do të finalizojmë dhe do të ketë mundësi që nga komuna të

përfitojnë 23 biznese prodhuese", ka deklaruar ministri Krasniqi. Kreu i MTI-së, Vesel Krasniqi, ka thënë se është diskutuar për dy investitorë të cilët Komunën e Vushtrrisë do ta kthejnë në zonë premuese për bizneset. "Diskutoam në takim në komunë edhe për dy investitorë që janë mjaft të rëndësishëm, investitorë strategjikë, që do të kenë mundësinë të investojnë në komunën tuaj, dhe kështu Komuna e Vushtrrisë do të

kthehet në një zonë biznesore, në një zonë premuese për bizneset prodhuese dhe ato tregtare", ka deklaruar Krasniqi.

Ministri Krasniqi ka thënë se kjo nuk është zona e fundit dhe do të krijohen zona ekonomike të reja edhe në komunat e tjera, ku do t'u jepet hapësirë të gjitha bizneseve në çdo komunë, që të kenë mundësi ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

Kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka falënderuar ministrin

Veseli për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e treguar për investime. Ai ka përmendur edhe investimet strategjike që po bëhen në këtë komunë. "Këto dy investime pritet të kompletohen në afat pesëvjeçar dhe natyrisht se ministri i ka dhënë një shtytje të re dhe jam i lumtur që Komuna e Vushtrrisë do të jetë përfituese nga sektori privat, i cili do ta transformojë Vushtrrinë dhe do t'i japë vlerë të shtuar edhe Kosovës", ka thënë Tahiri.

Lëvizja FOL: Qeveria Hoti realizoi vetëm 46 për qind të planit të punës për periudhën janar-shtator

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Lëvizja FOL, në kuadër të projektit "Forcimi i transparencës dhe llogaridhënies për reformat", me mbështetjen e Ambasadës Holandeze në Prishtinë, ka publikuar të martën të dhënat e monitorimit të zbatimit të planit vjetor të punës së

Qeverisë së Kosovës për periudhën janar-shtator 2020.

Ambasadorja holandeze në Prishtinë, Carin Lobbezo, ka thënë se ky raport vjen në kohë të duhur, pasi që së fundmi është publikuar raporti i progresit i Komisionit Evropian dhe ky raport forcon rolin e shoqërisë civile në forcimin e transparencës së qeverisë dhe ofron qytetarët me

proceset e rëndësishme që Kosova po kalon. "Ky raport, pasi që monitoron realizimin e planit të qeverisë nga secila ministri, mund të shfrytëzohet si një udhërrëfyes i rëndësishëm për qeverinë, në mënyrë që të reflektojë në punën e saj dhe të fokusohet në ndryshimet e nevojshme", ka thënë ambasadorja Lobbezo, duke shtuar se Holanda do të jetë afër

institucioneve të Kosovës dhe njerëzve të Kosovës në mënyrë që t'i ndihmojë vendit në rrugën e integritit evropian.

Erbllin Hoxha nga Lëvizja FOL ka thënë se kanë monitoruar planin vjetor të punës së 15 ministrive dhe Zyrën e Kryeministrit, të cilat, në bazë të realizimit të planit, tregojnë se ka pasur nivel të ulët të realizimit të planit të cilin e kishin

paraparë ta përfundonin për periudhën e parë nëntë. "Nga ky monitorim del se 154 aktivitete të parapara në planin vjetor të punës së qeverisë për periudhën janar-shtator 2020, vetëm 71 aktivitete janë realizuar 46 për qind, ndërkaq 83 aktivitete apo 54 për qind kanë mbetur të përcaktuar në afatin e përcaktuar kohor", ka thënë Hoxha.

Dy projektligje të MPMS-së kalojnë në Komisionin për Ekonomi dhe Punësim



Prishtinë, 3 nëntor (ER) - Të martën në Komisionin për Ekonomi, Punësim, Tregti, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka paraqitur dy projektligje të rëndësishme të hartuara nga Ministria e Punës dhe

Mirëqenies Sociale, konkretisht Projektligjin për Inspektoratin e Punës dhe Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L008 për Këshillin Ekonomiko-Social.

Ministri Reçica ka theksuar se të dy këto projektligje janë bazuar në standardet dhe praktikën më

të mira të marra nga vendet e rajonit dhe sipas standardeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës ILO. Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Ndërmarrësi dhe ai për Investime Strategjike kanë miratuar në parim këto dy projektligje dhe janë zotuar se do

të japin kontributin e tyre në të dy leximet me qëllim që këto dy projektligje të avancohen edhe më tej.

Ministri Reçica, gjithashtu, njoftoi anëtarët e komisionit për hapat që ka ndërmarrë MPMS-ja lidhur me njohjen e stazhit të punës për punonjësit e viteve '90

të larguar me dhunë nga puna nga regjimi serb i asaj kohe, se tashmë ka proceduar Projektligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti për miratim në qeveri, në bazë të të cilit parashihet njohja e këtij stazhi.

Numri i pacientëve që po trajtohen me Covid në spitalin e Gjakovës është i lartë

GJAKOVË, 3 NËNTOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka mbajtur takimin e radhës me Shtabin për Menaxhimin e Covid-19. Edhe një herë ai ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të institucionit komunal për t'i kryer të gjitha detyrat që i takojnë rreth parandalimit të përhapjes së virusit të rrezikshëm. "Çdo person që i nënshtrohet testimit për Covid-19 gjatë periudhës së pritjes së rezultatit duhet të qëndrojë në vetizolim. Po

ashtu, është e obligueshme që ata të cilët rezultojnë pozitivë, të qëndrojnë po në vetizolim. Ata të cilët nuk e respektojnë një gjë të tillë do ta marrin dënimin e merituar konform Ligjit për Covid-19. Ne si shtab dhe të gjitha institucionet relevante do t'i vëzhgojmë gjatë tërë kohës të gjithë personat pozitivë me virus dhe ata që janë në proces të testimit", ka thënë Gjini. Po ashtu, gjatë kësaj mbledhjeje u tha se Policia e Kosovës bashkë me inspektorët

komunalë do t'i vazhdojnë mbikëqyrjet strikte rreth respektimit të masave nga ana e bizneseve. Në bazë të informacioneve nga drejtori i spitalit, Hilmi Shala, numri i pacientëve që po trajtohen në këtë institucion shëndetësor është i lartë. Në këtë takim u tha se në mënyrë që të mos ketë përkeqësim të mëtejshëm të situatës, është e obligueshme që secili qytetar t'u përmbahet rekomandimeve të profesionistëve shëndetësorë.



Bëhet hapja e 26 puseve për familjet skamnore dhe institucionet në Ferizaj



FERIZAJ, 3 NËNTOR (ER) - Ka përfunduar projekti i nënshkruar në mes të organizatës së bamirësisë "Qatar Charity" dhe Komunës së Ferizajt për hapjen e 26 puseve,


respektivisht katër nga ato në institucione shkollore, një në institucion kulturor dhe 21 në familjet të cilat kanë mungesë të ujit të pijshëm, por nuk kanë mundësi financiare për të hapur me mjete vetjake.

Projekti është nënshkruar në korrik të këtij viti, ndërsa të martën është përfunduar i tëri, duke përfshirë hapjen e puseve, modifikimin me pajisje dhe pjesë përcjellëse dhe pranimin teknik.

Rinovohet Ambulanca e Mjekësisë Familjare në fshatin Babush

LIPJAN, 3 NËNTOR (ER) - Me investimin e Komunës së Lipjanit ditët e fundit kanë përfunduar punimet për renovimin e Ambulantes së Mjekësisë Familjare në fshatin Babush, ku është bërë lyerja e

objektit nga brenda, ndërimi i pllakave në ordianca dhe banja, rregullimi i pjerrinave për persona me nevoja të veçanta, vendosja e dritareve të reja si dhe rregullimi i ngrohjes qendrore (vendosja e kaldajës me rrymë).



KEDS-i po dyfishon kapacitetet e rrjetit në Fushë-Kosovë

FUSHE-KOSOVË, 3 NËNTOR (ER) - Gjatë këtyre ditëve KEDS-i është duke përfunduar një investim të jashtëzakonshëm në Fushë-Kosovë. Bëhet fjalë për pesë dalje të reja të tensionit të mesëm 20 kV (kilovolt), tri nga të cilat tashmë janë lëshuar në punë, ndërsa dy të tjerat lëshohen deri në fund të javës. "Ky është rrjet komplet i ri dhe përfshin të gjithë Fushë-Kosovën. Pra, përfitues është secili qytetar. Në të njëjtën kohë, për secilin konsumator do të ketë edhe linja alternative. Pra, nëse ndodh ndonjë e papritur në linjën ekzistuese

apo domosdoshmëri e ndonjë intervenimi, konsumatori furnizohet menjëherë nga linja tjetër, duke mos u ballafaquar me ndalesë të energjisë elektrike. Të gjitha këto dalje, që shtrihen në tërë territorin e qytetit, janë nëntokësore", ka njoftuar KEDS.

Fushë-Kosova është qyteti me rritjen më të madhe të popullatës në Kosovë. "KEDS-i e mori përsipër vetë situatën, duke e tejkaluar problemin e mbingarkesave të mëdha, të cilat gjatë dimrit ishin shumë problematike. Tashmë




qytetarët e kësaj komune nuk do ta kenë më këtë brengë, pasi është zgjidhur për një kohë të gjatë. Bashkë me rrjetin komplet të ri, janë duke u zëvendësuar edhe 50 trafo të reja, me kapacitete të

dyfishuara dhe me stabilimente përcjellëse. Gjatë zëvendësimit po bëhen ndërprerje të planifikuara të energjisë elektrike, pasi nuk mund të punohet nën tension dhe ky proces merr

mjaft kohë brenda një dite. Por, kjo bëhet që të përfitojnë qytetarët", ka njoftuar KEDS.

Projekti i Fushë-Kosovës është i ngjashëm me mega-projektin e Prishtinës, që paraqet gjithashtu zëvendësimin e rrjetit të vjetër me të ri, dyfishimin e kapaciteteve, hyrjen e kabllave nëntokë dhe krijimin e linjave alternative. Pos këtyre qyteteve, KEDS-i ka vendosur rrjetin nëntokësor ose është në proces edhe në disa komuna të tjera, si në Drenas, Vushtrri, Istog, Viti apo Podujevë.

Sfidat e sigurisë, në rritje



Shkruan: Ramadan QEHAJA

Shteti i Kosovës dhe shoqëria e saj vazhdojnë t'i ekspozohen një game të gjerë të sfidave e të rreziqeve si pasojë e jostabilitetit të brendshëm politik, krizës ekonomike dhe shëndetësore si dhe kërcënimeve pothuajse imanente nga jashtë, veçmas nga Serbia. Pavarësisht se të gjitha këto sfida pothuajse njëtrajtshëmrisht ndikojnë në brishtësinë e situatës së sigurisë në vend, do të ndalem kryesisht te sfida e fundit e cila shkaktohet nga faktori i jashtëm, Serbia.

S'do mend se Serbia ka shtuar përpjekjet për të betonuar një situatë të "konfliktit të ngrirë" me Kosovën. Ky skenar i shërben më së miri establishmentit ekzistues në Beograd sepse krijon rëndësi rajonale dhe ndërkombehtarë si shtet që mban çelësin e (jo)stabilitetit në Ballkan, por

edhe në rrafshin e brendshëm shfrytëzon fiksion shoqëror në Serbi me dominancën e tyre në raport me shtetet/popujt e tjerë në dëm të zhvillimeve negative të brendshme siç janë autokracia dhe mungesa e sundimit të ligjit. Serbia vijon të kalkulojë që qëllimet e saj strategjike vështirë se do t'i arrijë në formë të lehtë, siç janë integrimi i përshtetuar në BE apo edhe marrja e timonit për dominimin e popujve të tjerë më të vegjël, kështu që tani më synon ta përdorë instrumentin rus të shkakimit të problemeve dhe ngadalësimit të proceseve. Për t'i arritur këto qëllime ajo kombinon instrumente diplomatike, ushtarake e ekonomike si më poshtë:

Në aspektin diplomatik, Serbia haptas është angazhuar për jetësimin e partneriteteve strategjike me Kinën e Rusisë, fuqi këto të cilat hapur punojnë në dëm të interesave të shteteve perëndimore dhe organizatave multilaterale siç janë NATO dhe BE. Ajo përdor kontestin e pazgjidhur me Kosovën si një shantazh jo vetëm për Kosovën, por edhe shtetet perëndimore, duke rritur artificialisht pozicionin e saj më shumë se ç'mund të

projektojë. Me fjalë të tjera, veprimet e tilla dëshirojnë të dërgojnë mesazh (pjesërisht me sukses deri më tani), se Serbia vendos për stabilitetin në rajon përderisa është faktor "vendimmarrës" në raport me Kosovën dhe Bosnje e Hercegovinën.

Në aspektin ushtarak, armatosja e Serbisë përtej nevojës vetëmbrojtëse të saj nuk duhet parë si një veprim të një vendi sovran, por si një kërcënim immanent për fqinjët e sidomos Kosovën. Ajo vijon armatosjen me armatim ofanziv përfshirë dhe raketat tokë-ajër nga Rusia e Kina përderisa në anën tjetër është tërhequr nga kontributi me forca në misionet paqeruajtëse të BE-së dhe të OKB-së. Dislokimi i shtuar i forcave në kufi me Kosovën përbën shqetësim permanent për popullatën përderisa skenari i shfrytëzimit të një momenti të volitshëm për dislokim forcash në veri duket çdoherë më i pranishëm. Serbia do të synojë ta shfrytëzojë mungesën e një kohezioni të madh brenda NATO dhe rrjedhimisht brenda kontingjenteve të KFOR-it, ku pjesë e saj janë edhe njësitë nga disa shtete të cilat kanë

marrëdhënie të shkëlqyera me Beogradin e sidomos me presidentin serb Vuçiq. Megjithatë, duhet pranuar që gatishmëria vepruese e ushtrisë serbe nuk është në nivelin siç proklamohet duke pasur parasysh rënien e moralit të ushtarëve e eprorëve serbë dhe numrit të madh largimesh të personelit.

Në aspektin ekonomik, Serbia do të tentojë ta shtrijë dominimin nëpërmjet produkteve duke subvencionuar kompanitë për ta rikthyer tregun në Kosovë. Ajo ekonominë e sheh si instrument jo të bashkëpunimit rajonal, por të hegjemonisë në dëm të Kosovës dhe shteteve të tjera më të vogla. Tregues të kësaj gjendje janë barrierat jotarifore që i imponohen prodhuesve tanë si dhe vështirësitë që iu shkaktohen ndërmarrësve tanë për eksportimin e mallrave në Serbi dhe ato të cilat kanë për transit Serbinë.

Me gjithë këto sfida, pyetja shtrohet se si duhet ne t'u kundërvihemi këtyre veprimeve destruktive nga Beograd?

Sigurisht se qeveria ekzistuese ka një bazë të dobët qoftë në aspektin e resurseve, por edhe në aspektin e legjitimitetit të saj

për t'u rezistuar sfidave që vijnë nga jashtë. Megjithatë, pa hyrë në aspektin ekonomik dhe politik që kërkojnë një shtjellim më të madh, qeveria duhet që ta shtyjë përpara procesin e tranzicionit të FSK-së në ushtri i cili duket se nuk është sipas dinamikës së paraparë. Dinamika e këtij tranzicioni është jetik në raport me sfidat strategjike që vijnë nga Serbia dhe rrjedhimisht Ministria e Mbrojtjes duhet të kursehet në maksimum nga implikimet buxhetore sado që mund të justifikohen ato për momentin e pikërishtëm. Po ashtu, qeveria duhet ta shtojë komunikimin me KFOR dhe të ushtrojë një formë të "pronësisë" ndaj temave ushtarake, përfshirë edhe ato brenda fushëveprimit të KFOR-it, duke ruajtur rëndësinë dhe ushtruar autoritetin civil, sidomos në raport me temat e sfidat jetike sikurse kjo. Në anën tjetër, duhet edhe një mobilizim më i shtuar i policisë dhe rritja e gatishmërisë vepruese, në veçanti e Njësisë Speciale, e cila duhet të jetë e gatshme si ndërhyrëse e parë në raport me ruajtjen e kufirit dhe me zhvillimet e mundshme në veri dhe gjetiu.

Na duhet një tryezë e partive, e ngjashme me Kongresin e Lushnjës



Milazim KRASNIQI

Kosova po fundoset për çdo ditë. Fajin primar e ka Serbia, e cila po e minon çdo përpjekje të Kosovës për konsolidim. Fajin e madh e ka edhe Bashkimi Evropian që po

e favorizon Serbinë. Faj të rëndë kanë armiqët e Kosovës, Rusia e Kina, që e kanë bllokuar në OKB dhe gjithandej. Por, fajin e pafalshëm e kanë politikanët tanë që nuk po gjejnë rrugëzgjidhje. (Nuk është arsytim të thuhet se nuk po mundemi, ose nuk po dimë. Ata janë aty për të mundur e për të ditur.) Fatkeqësisht, ata kanë hyrë në skemën e armiqve të vendit tonë e po sillen si të humbur.

Mua kjo javë më duket

vendimtare për fatin e Kosovës. Jo për zgjedhjet në ShBA. Për veprimet që duhet të ndërmerren në Kosovë.

Veprimi që mund ta shpëtojë vendin nga kolapsi dhe nga dezintegrimi është një tryezë e përbashkët e partive kryesore politike (LVV, LDK, PDK, AAK, Nisma dhe AKR, ku do të arrihej pajtim për këto çështje: a) ngritja e menjëhershme e padisë për gjenocid kundër Serbisë, b) ndryshimi i mandatit të Gjykatës Speciale, duke përfshirë të gjitha krimet

e luftës, pra edhe të ushtrisë, policisë, administratës e qeverisë së ish Jugosllavisë e të Serbisë në vitet 1989-1999, (gjithsesi duke përfshirë Vuçiqin e Daçiqin) c) ndryshimi i ligjit të zgjedhjeve, duke futur sistem mazhoritar me zona zgjedhore dhe duke eliminuar aspektet bllokuese nga statusi i minoriteteve, d) duke ngrirë statusin e komunave rurale të formuara nga Plani i Ahtisarit, deri sa Serbia ta pranojë atë Plan, e) zgjedhja e presidentit të bëhet

me zgjedhje direkte, f) formimi i një qeverie gjithëpërfshirëse, me një kryeministër nga partia e parë e zgjedhjeve të 6 tetori 2019, por që pranohet me konsensus nga partnerët e koalicionit. dhe g) marrëveshje që zgjedhjet parlamentare e presidenciale të mbahen në prill 2021.

Nëse merren këto vendime urgjentisht, gjatë javës vendi do të shpëtohej. Siç u shpëtua Shqipëria në Kongresin e Lushnjës.

Arrestohen pesë persona në Deçan për veprat penale 'lëndim i lehtë trupor' dhe 'kanosje'

Nga njësitë përkatëse të policisë janë ndërmarrë masat e nevojshme të menjëhershme dhe katër personat e dyshuar në këtë rast janë arrestuar


Deçan, 3 nëntor (ER) - Policia e Kosovës, Stacioni Policor Deçan, më 02. 11. 2020 ka pranuar një informatë se në fshatin Strellcë të Epërm në Deçan disa persona janë duke u rrahur. Njësitë policor nga stacioni policor në Deçan menjëherë ka dalë në vendin e ngjarjes.

Nga njësitë përkatëse të policisë janë ndërmarrë masat e nevojshme të menjëhershme dhe katër personat e dyshuar në këtë rast janë arrestuar.

Më pas nga personi i dyshuar (familjar i të dyshuarve të tjerë) është kanosur viktima e rastit, ku policia menjëherë ka arrestuar edhe këtë të dyshuar

për veprën penale "kanosje". Për rastin është informuar prokurori dhe me vendim të tij personat e dyshuar për veprat e lartcekura janë ndaluar për 48 orë. Policia ka njoftuar se hetuesit janë duke punuar me prokurorin e shtetit për t'i sqaruar të gjitha rrethanat e këtij rasti.





Izet Sarajliqi (1930-2002) është një ndër poetët boshnjak më të njohur. Sarajliqi është konsideruar një prej autorëve kryesorë të Evropës Lindore dhe është kandiduar për çmimin Nobel për letërsi. Sarajliqi ka qenë anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Bosnje dhe Hercegovinës. Është vlerësuar me shumë çmime, edhe me çmimin prestigjioz "Alberto Moravia" (2001). Gjatë luftës (1992-1995) refuzoi të largohej nga Bosnja. Në këtë luftë, në të cilën u plagos, humbi dy motrat, Ninën dhe Razën, të cilat përmendën në këtë libër. Poezitë e Sarajliqit janë përkthyer dhe botuar në: italisht, frëngjisht, holandisht, gjermanisht, slovenisht, rusisht, lituanisht, anglisht, turqisht, maqedonisht, spanjisht, në gjuhën polake e në disa gjuhë të tjera të botës, edhe në shqip.



Në parathënien e këtij libri është ky paragraf: *Në Sarajevë, të cilën e deshi shumë dhe me poezi shkruar për të e bëri të njohur në mbarë botën, pothuajse askush nuk e kujton më. Madje asnjë rrugë të këtij qyteti nuk ia dhanë emrin e tij.* Kështu shkruan dhe shpreh shqetësim e bija e poetit, Tamara Sarajliq Slavniq, e cila, në korrespondencat me postë elektronike, na njofton se babai i saj, Izeti, sa ishte gjallë kishte qenë disa herë në Prishtinë, se i donte shumë shqiptarët, se u fliste fëmijëve të vet shumë për qytetet e Kosovës, për takimet që kishte pasur disa herë me poetë shqiptarë në mbremjet poetike që atëkohë organizoheshin në Kosovë dhe në Maqedoni. Po ashtu, shpreh kënaqësi që, pas librit të parë, *Kërkoj rrugë për emrin tim*, përkthyer në gjuhën shqipe, në fund të viteve '70, nga Azem Shkreli, Enver Gjergjeku, Qerim Ujkani, Ali Podrimja dhe botuar nga Rilindja më 1978, po në shqipe po i përkthehet dhe botohet libri i dytë, *Përmbledhja sarajevase e luftës*. Falënderimet e saj, për shtëpinë tonë botuese dhe për ata shqiptarë që kujdesen për vlera letrare dhe njerëzore, për ata shkrimtarë që i do dhe i kërkon bota, që janë institucione të kujtesës kombëtare, që ua kujtojnë gabimet shteteve dhe udhëheqësve të tyre, janë shumë të njerëzishme dhe janë shumë miqësore. Pas shumë fjalëve të saj për punën tonë, i kemi dërguar në fund këtë fjali: *Boshnjakët edhe mund ta barrojnë luftën, edhe ta barrojnë Sarajliqin, por ne s'do ta barrojmë kurrë luftën e Bosnjës në vargjet e Izetit; s'do ta barrojmë kurrë masakrën që i është bërë popullit të tij; s'do ta barrojmë kurrë fatin e përbashkët që kishim: ju vetem atje, ne shqiptarët këtu.*

N. Sh. Armagedoni

4.99 €



PËRMBLEDHJA SARAJEVASE E LUFTËS



IZET SARAJLIQ

Përkthues: Salajdin Salihu
Shkroi parathënien: Tamara Sarajliq Slavniq



Realiteti i hidhur kosovar vjen nëpërmjet skulpturave të Eroll Muratit



Tri skulpturat e mbështjella me zingjirë bardh e zi të ekspozitës “Skulptura në hapësirë” nga artisti Eroll Murati bënë që qytetarë të shumtë të ndaleshin, fotografoheshin dhe pajtoheshin me mesazhin goditës që përçonin këto vepra arti

Të ekspozuara në sheshin “Skënderbeu” të kryeqytetit, skulpturat i falnin një pamje të freskët kësaj hapësire publike, duke i bërë të pranishmit të depërtonin në thellësinë e artit. Sytë e qytetarëve kalonin sa nga njëra sa te tjera skulpturë, duke e bërë që interesimi për t’i kuptuar ato të zgjohej edhe më shumë.

Tri pozicionet e ndryshme të skulpturave bashkë me veçantitë krijuese, bënë që të përçonin dromca të realitetit. Në intervistën për KultPlus, Murati tregoj se çdo detaj është i menduar dhe i qëllimshëm, në mënyrë që sa më thjeshtë të kuptohet mesazhi i ekspozitës që do të jetë e hapur deri më 25 nëntor.

Zingjiri i përdorur tregon ashpërsi, ndërkaq e zeza dhe e bardha vjen si një kombinim mes personaliteteve të ndryshme të njerëzve, duke e bërë që veprimet individuale të përfaqësojnë shoqërinë.

“Bardh e zi ka qenë e qëllimshme për shkak që me të zezen e kam paraqitur të errëtin, të keqin e të dobëtin dhe të bardhën e kam përdorur si

zemërbardhësi, diçka shumë e mirë”, u shpreh Eroll Murati.

Përderisa qëllimi kryesor mbetet sjellja e skulpturave moderne dhe kreativitetit artistik në hapësira publike, në këndvështrimin e parë ai thekson se nëpërmjet kësaj ekspozite çdo qytetari iu ekspozohet realiteti i hidhur kosovar.

Skulptura e parë e Muratit përbëhet nga një person i vetëm, i cili gjendet në këmbë, me duar të mbështjella me zingjirë të zinj, e që kjo tregon një izolim, ku përherë ekziston një tentativë që i miri të mbështjellët me diçka të keqe.

Ndërkaq, krijimi i dytë artistik e kalon rrafshin individual dhe del në pah ndërveprimi social dhe ndikimi i tij. Kësisoj, dy skulptura njerëzish tërësisht të zinj, e thënë figurativisht “të pushtuar nga e keqja” mbajnë në duar të tyre zingjirë të cilët dërgojnë te një karrige, e që kjo mund të përkthehet si luftë për pushtet nga çdo hallkë shoqërore.

“Për luftën e karriges mund të shtyhet apo të luftoj dhe një nxënës, student, profesor,

deputet dhe gjithkush tjetër”, shprehet artisti Murati.

Edhe skulptura e tretë është një bashkëveprim social mes dy individëve, veçse kësaj radhe nuk ka një ngjyrë të njëjtë që i mbulon të dyja. Një skulpturë që qëndron në këmbë dhe ka ngjyrë të zeza, shfaqet përballë skulpturës tjetër, e cila është e bardhë. Kjo vjen si një përpjekje e të keqit që t’ia marr edhe pak të mirë që i ka mbetur tjetrit dhe ta shndërroj sikur veten e tij.

“E treta është konsumimi i njeriut të mirë nga i keqi, duke u munduar t’ia merr edhe ata të bardhë që e ka”, shprehet Murati.

Përtej mesazhit të kësaj ekspozite, Murati mendon që shumica e krijimeve artistike të vendit shfaqen nëpër muze, hapësira të mbyllura e vende të tjera kulturore, ndërkaq nëpërmjet zgjedhjes së një hapësire publike, ai ka tentuar të sjell diçka të re edhe në këtë dimension.

Për sa i përket natyrës së ekspozitës “Skulptura në hapësirë”, ai thekson se njerëzit janë mësuar të shohin shfaqje të tilla artistike nëpër media dhe



krijime të vendeve tjera, si të Evropës ashtu edhe në pjesët tjera të botës. Ndërkaq, ai ka zgjedhur vendin e tij për një sërë arsyes.

“Unë desha ta bëj në vendin tim, si vendi i cili më ka bërë krenar dhe më ka frymëzuar. Ta dinë qytetarët se edhe ne kemi artistë shumë të mirë në Kosovë”, tha Murati.

Ndërkaq për relacionin art-hapësirë publike në vendin tonë, ai shprehet se ndjehet i kënaqur për shkak të shfrytëzimit të tyre që një kohë të gjatë.

“Kemi hapësira shumë të bukura që i përshtaten skulpturave moderne, për shembull sheshi “Skënderbeu” është i madh dhe i mirë”, shprehet autori i ekspozitës “Skulptura në hapësirë”.

Tutje ai thekson se artistët një herë vëzhgojnë terrenin e duhur dhe pastaj vendosin se ku do t’i ekspozojnë veprat e tyre. Ekspozita “Skulptura në hapësirë” është mbështetur nga Komuna e Prishtinës, gjegjësisht Drejtoria e Kulturës. /Medina Pasoma /KultPlus



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Për herë të parë ftohen Daku dhe Fazliji, rikthehet Berisha

Mirlind Daku dhe Betim Fazliji janë risitë në listën e Bernard Challandesit për tri ndeshjet e këtij muaji, kurse trajneri zviceran e ka rikthyer në përfaqësuese edhe Bernard Berishën



LISTA E FUTBOLLISTËVE

Samir Ujkani, Arjanet Muriq, Visar Bekaj, Mërgim Vojvoda, Florent Hadergjonaj, Amir Rrahmani, Fidan Aliti, Ibrahim Dreshviq, Betim Fazliji, Lert Paqarada, Benjamin Kololli, Herolind Shala, Hekuran Kryeziu, Anel Rashkaj, Idriz Voca, Valon Berisha, Bersant Celina, Bernard Berisha, Milot Rashica, Elbasan Rashani, Edon Zhegrova, Lirim Kastrati, Florent Hasani, Florent Muslija, Vedat Muriqi, Atdhe Nuhiu, Mirlind Daku.

Zeneli. Ky i fundit mungon për shkak të lëndimit që ka pësuar me skuadrën e Stade de Reims.

Kosova më 11 nëntor e zhvillon miqësoren kundër Shqipërisë, kurse në kuadër të Grupit 3 të Ligës C në Ligën e Kombeve takohet me Slloveninë më 15 nëntor në Lubjanë dhe më 18 nëntor e pret në stadiumin "Fadil Vokrri", Moldavinë. "Dardanët" do të grumbullohen më 9 nëntor në Durrës, ku do t'i zhvillojnë përgatitjet për miqësoren me Shqipërinë.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, e ka publikuar listën e lojtarëve për tri ndeshjet e këtij muaji. "Dardanët" do të përballen në miqësoren vëllazërore me Shqipërinë, derisa në Ligën e Kombeve do të luajnë kundër Sllovenisë dhe Moldavisë. Për herë të parë në Përfaqësuesen A nga përzgjedhësi zviceran janë ftuar sulmuesi i Ballkanit, Mirlind Daku dhe Betim Fazliji i St. Gallenit në Zvicër. Daku është futbollisti i vetëm nga Superliga e Kosovës që ftohet në Përfaqësuesen A. Në listën prej 27 futbollistëve vërehet edhe rikthimi i Bernard Berishës, i cili nuk u ftua për

ndeshjet e tetorit pas një përplasje me trajnerin Challandes.

Futbollisti 29-vjeçar i Akhmat Grozny, Bernard Berisha, që po gëzon një formë të lartë në kampionatin rus të futbollit, të martën në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar: "Gjithmonë i gatshëm për ty Kosova ime". "Përzgjedhësi Challandes për këto tri ndeshja ka ftuar 27 futbollistë, si dhe dy lojtarë i ka në listën rezervë. Për herë të parë janë ftuar Betim Fazliji nga klubi zviceran St. Gallen dhe sulmuesi i Ballkanit, Mirlind Daku, i cili deri më tash ishte pjesë e Kombëtares U21", thuhet në njoftimin e Federatës së Futbollit të Kosovës. Mungesa më e madhe e Kosovës në për këto tri ndeshje është ajo e anësorit, Arbër

Peja kërkon fitoren e tretë në Prizren

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Në mesjavë do të zhvillohet xhironja e tretë në Superligën e Kosovës në basketboll. Sot (e mërkurë) do të zhvillohen dy ndeshje, ku Trepça e pret Golden Eagle Ylli në Mitrovicë. Mitrovicasit kanë pësuar dy humbje nga dy ndeshje të zhvilluara, kurse therandasit kanë dy fitore nga dy ndeshje në këtë edicion. Ponte Prizreni-Peja është një takim shumë interesant, ku prizrenasit kanë një fitore dhe një humbje në këtë edicion, kurse pejanët dy fitore nga dy ndeshje dhe do të



përpiqen ta vazhdojnë ecurinë pozitive. Rahoveci - Sigal Prishtina, po ashtu, shihet si një përballje mjaft interesante, ku në vitet e fundit takimet mes këtyre dy skuadrave kanë qenë shumë interesante dhe dramatike. Bardhekaltrit i mundën në gjysmëfinale të Superkupës, andaj ky takim po pritët me interesim të madh. Të dyja skuadrat kanë një fitore dhe një humbje. Bashkimi, që ishte finalist i Superkupës, do të ndeshet me Vëllaznimin, që ka hyrë nga Liga e Parë në

Superligë. Prizrenasit kanë një fitore dhe një humbje, kurse kuqezinjtë dy humbje nga dy ndeshje.

SUPERLIGA - Java 3

Të mërkurën takohen:
19:00 Trepça - Golden Eagle Ylli
19:00 Ponte Prizreni - Peja

Të enjten takohen:
19:00 Rahoveci - Sigal Prishtina
19:00 Bashkimi - Vëllaznimi

Kosova sonte përballët me Malin e Zi



Prishtinë, 3 nëntor - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll ka përfunduar stërvitjet në Prishtinë për ndeshjen ndaj Malit të Zi, që zhvillohet të mërkurën në

Podgoricë (20:30). Ndeshja me Malin e Zi vlerësohet e vështirë, por të gjithë premtojnë më të mirën. Kosova të martën udhëtoi për në Podgoricë, ku pas mbërritjes zhvilloi edhe një

stërvitje tjetër. Shpirti luftarak është parë edhe në stërvitjet e së hënës, ndërsa grupi është i bashkuar dhe kjo ka qenë në ndeshjet e fundit forca kryesore e Kosovës. "Nëse luajmë të

bashkuar ashtu si në Itali, nëse të gjithë japim më të mirën, atëherë besoj se kemi gjasa të mira për paraqitje dinjitoze, një që i bën nder vendit", ka thënë kapiteni Valon Dedaj.

Sot zhvillon tri ndeshje në Superligë

PRISHTINË, 3 NËNTOR - Tri ndeshje të javës së njëmbëdhjetë në Superligën e Kosovës në futboll zhvillohen sot (e mërkurë).

Ndeshje interesante do të jetë ajo në mes të Trepçës '89 dhe kampiones në fuqi, Dritës. Kjo ndeshje zhvillohet në Mitrovicë

nga ora 13:30, kurse Prishtina e pret Arbërinë në stadiumin "Fadil Vokrri". Në ndeshjen tjetër takohen Besa e Pejës dhe

Drenica. Dy ndeshjet e tjera zhvillohen të enjten dhe takohen Gjilani - Llapi dhe Feronikeli - Ballkani.



Halep infektohet me koronavirus, mbyll para kohe sezonin

BUKURESHT, 3 NËNTOR - Tenistja rumune Simona Halep, numërdy në botë për femra, ka konfirmuar se ka dalë pozitive me Covid-19, pas një testi të kryer në vendlindje. Ajo ka shtuar se ndodhet prej tri

ditësh në izolim dhe se ka simptoma të lehta. "Dua t'ju bëj me dije se kam rezultuar pozitive pas një testi. Jam në izolim me simptoma të lehta. Jam mirë. Do të kaloj", ka shkruar Halep. Kjo ndalesë e

papritur ka prishur disi planet e tenistes rumune, që praktikisht ka mbyllur edhe sezonin 2020, duke mos luajtur as në finalen e WTA Championship. Këtë vit Simona Halep ka fituar tre

turne (Dubai, Praga dhe Romë), por u mund në finalen e Roland Garros një muaj më parë. Ajo pritet të rikthehet në fushë në grand slam të Australian Open në janarin e vitit tjetër.



Rikthehet përballja Leipzig - PSG



LEIPZIG, 3 NËNTOR (ER) - Rikthehet përballja në mes dy skuadrave që u takuan në gjysmëfinale të Ligës së Kampionëve në edicionin e kaluar mes RB Leipzig dhe Paris Saint-Germain. Kësaj radhe këto dy skuadra takohen në kuadër të Grupit H në Ligën e Kampionëve, por një fakt interesant është se Leipzig dhe PSG-ja janë mposhtur sivjet nga Manchester Unitedi dhe sonte kërkojnë pikët për t'i shtuar gjasat e kualifikimit në fazën tjetër. Në gjysmëfinale të edicionit të kaluar me e suksesshme kishte dalë PSG-ja, por kësaj radhe gjermanët do të kërkojnë të "hakmerren" për atë eliminim, por edhe për t'i ruajtur shpresat për kualifikim. Në anën tjetër edhe francezët kanë grumbulluar vetëm tri pikë dhe synojnë që ta marrin fitoren e dytë në këtë edicion. Vendësve u mungojnë Marcel Halstenberg, Fabrice Hartmann, Lucas Klostermann dhe Konrad Laimer, kurse rikthehet Emil Forsberg. Ndërsa mysafirëve u mungojnë Mauro

Icardi, Leandro Paredes, Marco Verratti, Julian Draxler, Neymar, Juan Bernat dhe Alexandre Letellier. Në ndeshjen tjetër të këtij grupi, Manchester United e kërkon fitoren e tretë ndaj Basaksehirit në Turqi. Në Grupin F, Lazio e Vedat Muriqit dhe Thomas Starkoshës i shkon

në Rusi Zenitit me synim për ta marrë maksimumin e pikëve dhe të mbetet në pozitën e parë të grupit. Ndeshje interesante do të jetë edhe në mes të Club Brugge dhe Borussia Dortmundit, që kërkojnë fitoren në Belgjikë për të mbetur në hap për kualifikim.

GRUPI E			GRUPI G		
21:00 Chelsea - Rennes 21:00 Sevilla - Krasnodar			21:00 Barcelona - Dynamo Kyiv 21:00 Ferencvaros - Juventus		
Tabela			Tabela		
		PIKË			PIKË
1. Chelsea	2	4	1. Barcelona	2	6
2. Sevilla	2	4	2. Juventus	2	3
3. Krasnodar	2	3	3. Dynamo Kyiv	2	1
4. Rennes	2	3	4. Ferencvaros	2	1
GRUPI F			GRUPI H		
18:55 Zenit - Lazio 21:00 Club Brugge - B. Dortmund			18:55 Basaksehir - M.United 21:00 Leipzig - PSG		
Tabela			Tabela		
		PIKË			PIKË
1. Lazio	2	4	1. United	2	6
2. Club Brugge	2	4	2. PSG	2	3
3. Dortmund	2	3	3. Leipzig	2	3
4. Zenit	2	0	4. Basaksehir	2	0

SHKURT

Kosova, me tre boksierë shkon në Evropianin e të Rinjve

Në Kampionatin Evropian të Boksit për grupmoshat 17-18 vjeç që mbahet në Budva, Kosova do të përfaqësohet me Luar Aliun 56 kilogramë, Qlirim Berishën 64 kg dhe Remzo Mustafiç 91 kg. Ndërsa gjyqtari ndërkombëtar, Latif Demolli, do ta ndajë drejtësinë. Për shkak të lëndimit, Leonit Gubetini, boksieri i kategorisë 69 kilogramë, nuk do të udhëtojë drejt Malit të Zi. Tre boksierët, së bashku me selektorin Shefki Bogujevci, kanë udhëtuar për përgatitje të përbashkëta me Shqipërinë në Durrës.

Kamberi rezulton pozitiv me Covid-19

Sulmuesi Florian Kamberit i duhet të presë akoma për të luajtur me fanellën e Kombëtares së Shqipërisë. Sulmuesi, prej të cilit pritet shumë, nuk do të jetë gati për t'u grumbulluar me kuqezinjët as për ndeshjet e nëntorit. Shkak për këtë bëhet, fakti se sulmuesi ka rezultuar pozitiv ndaj koronavirusit. Pas tamponëve të kryera së fundmi te skuadra zvicerane e St. Galenit, është zbuluar se Kamberi ishte pozitiv. Pas kësaj, lojtari është futur menjëherë në karantinë dhe do të qëndrojë aty derisa t'i largohet virusi.

Maradona shtrihet në spital

Legjenda e futbollit argjentinas, Diego Maradona, është shtruar në spital. Mjeku personal i tij, Leopoldo Luque, ka njoftuar se pacienti i tij ka probleme me frymëmarrjen, mirëpo nuk është bërë me dije nëse është i infektuar me koronavirus. Maradona, që ka mbushur 60 vjet të premtën, është pranuar në klinikën e qytetit La Plata, disa kilometra nga Buenos Aires. Ylli i dikurshëm i futbollit argjentinas ishte izoluar javë më parë pasi që kishte pasur kontakte me një person të infektuar me Covid-19.

City në janar e dëshiron Messin

Manchester City është duke u përgatitur për transferimin e Leo Messit në muajin janar, raporton "The Telegraph". City kërkon të përfitojë nga kriza totale që ka mbërthyer ekipin blaugrana, pa president dhe në prag të kolapsit financiar. Të dhënat e radhës erdhën pak ditë më parë nga vetë drejtori i operacioneve financiare në klubin e Manchester Cityt, Omar Berrada: "Është një talent i jashtëzakonshëm, mund të ketë një impakt shumë domethënës në çdo klub të botës, brenda dhe jashtë fushe. Është futbollisti më i mirë në botë, më i miri në gjeneratën e tij. Mendoj se çdo klub në botë do t'i pëlqente ta kishte në dispozicion. Nëse Messi vendos të largohet nga Barcelona, do ta marrim në konsideratë mundësinë për ta transferuar".

Atletico transferon Kondogbiam

Atletico Madridi e ka konfirmuar blerjen e Geoffrey Kondogbia nga Valencia, për një shumë prej 15 milionë eurosh. Atletico i lejua ta sjellë mesfushorin francez si zëvendësues emergjent jashtë afatit kalimtar të futbollistëve, sepse Arsenali e kishte paguar klauzolën e Thomas Partey në ditën e fundit të afatit kalimtar të verës në tetor. Kondogbia do të kalojë nga "Mestalla" në "Estadio Wanda Metropolitano" për 15 milionë euro. Mesfushori 24-vjeçar ka nënshkruar kontratë me Atletico deri në vitin 2024.

Milani i ofron kontratë të re Ibrës

AC Milan është duke punuar që t'i vazhdojë kontratën Zlatan Ibrahimoviçit edhe për një vit. Sulmuesi suedez pak muaj më parë rinovojë kontratë me

"Rossonerët" deri në vitin 2021, derisa forma e tij është mbresëlënëse. Sipas asaj që raporton "Calciomercato", Milani nuk dëshiron ta lëshojë

Ibrahimoviçin deri në vitin 2022, duke i ofruar një marrëveshje të re. Sulmuesi 39-vjeçar u rikthye në "San Siro" në afatin e janarit si lojtar i lirë,

pasi kontrata me La Galaxy skadoi në dhjetor të vitit të kaluar. Ibrahimoviç ka shpërthyer në këtë edicion, pasi ka shënuar shtatë gola në katër

ndeshje në Serie A. Me ndihëm e tij, Milani vazhdon të jetë lider i ligës italiane, e që rikthimi i tij në "San Siro" ka sjell freski në skuadrën kuqeziti.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 335/1
 Dt: 03.11.2020

Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vend i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHMLT	"11 Marsi"	Prizren	Një (1) mësimdhënës/e të Dizajnit të Veshjes; normë e plotë	deri më 10.07.2021
			Një (1) mësimdhënës /e të Teknologjisë së Informacionit dhe Telekomunikacionit; 15 orë mësimore;	deri më 31.08.2021
			Një(1) mësimdhënës/e të Matematikës për mësim në Gjuhën Boshnjake; 17 orë mësimore;	deri më 31.08.2021
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një(1) mësimdhënës/e për lenden e TIK-ut me normë të plot;	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë
			Një(1) mësimdhënës/e për mësimin praktik për profilin Siguri e Ushqimit dhe Dietat me normë të plot;	Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2018, Udhëzimit Administrativ 07/2017 si dhe në bazë të kërkesës së shkollës, Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

Ri-SHPALLJE E KONKURISIT

Për plotësimin e vendeve të lira në Sh. M. L. T "11 Marsi" në Prizren dhe në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj për vitin shkollor 2020/2021

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoh udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPARr-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.

- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe procese mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën tryzni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 7 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi gjegjësisht në Sh. M. L. T "11 Marsi" në Prizren dhe në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale. Në mungesë të kandidatëve me kualifikim adekuat në intervistë thirren edhe kandidatët me kualifikim të përafërt, në të kundërtën intervistohen vetëm kandidatët me kualifikim përkatës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "BEXHA - TAXI" SH.P.K. me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. UNIK: 811182930, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavjanje se svi klienti da drustvo sa "BEXHA-TAXI", D.O.O. od Gnjilane, donelo odluku o prestani rada sa nr. 811182930, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "BEXHA - TAXI" L.L.C. in Gjilan, has come to the decision to quit its nr. 811182930, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo



DREJTORIA E ARSIMIT



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në bazë të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës neni 5 pika c, Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës neni 35, dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr 07/2017, për Rregullimin e procedurave të konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria e Arsimit në Gjiçan shpallë këtë :

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

I. Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta (SHFMU)

- SHFMU "Thimi Mitko" në Gjiçan**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së historisë për 10 orë, pushim i lehonisë deri më 28.02.2021
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së kimisë, pushim pa pagesë deri më 30.04.2021
 - Një mësimdhënës/e i ciklit klasor, pushim i lehonisë prej datës 02.11.2020
 - SHFMU "Selami Hallaqi" në Gjiçan**
 - Një edukatore
 - Një mësimdhënës/e i ciklit klasor, pushim i lehonisë deri më 28.02.2021
 - Një mësimdhënës/e i ciklit klasor, pushim pa pagesë deri më 31.10.2021
 - SHFMU "Liria" në Pogradec**
 - Një mësimdhënës/e, e lëndës Edukatë Fizike me 16 orë, deri me 31.08.2021
 - SHFMU "Agim Ramadani" në Zhegër**
 - Një mësimdhënës/e i ciklit klasor, pushim i lehonisë, prej datës 15.11.2020
 - SHFMU "Rexhep Elmazi" në Gjiçan**
 - Një mësimdhënës/e i ciklit klasor me kohë të caktuar (vendi i drejtorit të shkollës)
 - Një mësimdhënës/e i lëndës Edukatë Qytetare 3 orë me plotësim norme 9 orë Mësim Zgjedhor deri më 30.06.2021
 - SHFMU "Ibrahim Uruqi" në Bresalec**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës edukatë qytetare për 13 orë, pushim i lehonisë deri me datën 31.03.2021
 - Një mësimdhënës/e i ciklit klasor, pushim i lehonisë, prej datës 01.12.2020
 - SHFMU "Bajram Curri" në Shurdhan**
 - Një mësimdhënës/e i ciklit klasor deri me 31.08.2021
 - SHFMU "Afërdita" në Kishnapole**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së fizikës 14 orë në Kishnapole dhe Sllakove
 - SHFMU "Vatra e Diturisë" Livoq i Epërm**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së TIK-ut me 10 orë plotësim norme 10 orë në SHFMU "Agim Ramadani" në Zhegër deri me datën 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e i lëndës Edukatë Qytetare 10 orë me plotësim norme 3 orë Mësim Zgjedhor deri 31.08.2021
 - SHFMU "Skënderbeu" në Gjiçan**
 - Dy mësimdhënës/e i ciklit klasor në paralelën e ndarë në Verbicë deri me datën 31.08.2021
 - SHFMU "Feta Qerimi" në Verbicë të Zhegocit**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së gjuhës angleze 10 orë, pushim pa pagesë deri 30.09.2021
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së fizikës me 16 orë, në paralelën e ndarë Zhegoc deri më 31.08.2021
 - SHFMU "Veseli Muji" në Mihir**
 - Një mësimdhënës/e i ciklit klasor, pushim pa pagesë deri më 31.05.2021
 - SHFMU "Nazim Hikmet" në Dobërçan**
 - Një edukatore
 - SHFMU "Abdulla Tahiri" në Malishevë**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së Gjeografisë me 10 orë deri me 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së Historisë, pushim i lehonisë deri me 31.12.2020
 - SHFMU e Muzikës**
 - Dy mësimdhënës/e për lëndën Kitarë, njëri me 20 orë dhe tjetri me 10 orë deri me 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e për lëndën Piano, me 20 orë, pushim pa pagesë deri më 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e për lëndën Trompetë , me 10 orë, deri me 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e për lëndën Perkusione, me 10 orë, deri me 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e për lëndën Violinës , me 20 orë, deri me 31.08.2021
 - SHFMU "Zija Shemsiu" në Gjiçan**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së gjuhës gjermane me 11 orë, plotësim norme në SHFMU "Liria" me 8 orë, deri me datën 31.08.2021
 - SHFMU "Dëshmorët e Kombit" në Livoq të Poshtëm**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së gjuhës gjermane me 8 orë, plotësim norme në SHFMU "Afërdita" me 7 orë, deri me datën 31.08.2021
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së gjuhës shqipe 6 orë dhe 4 mësim zgjedhor, deri me 30.06.2020
 - SHFMU "Musa Zajmi" në Gjiçan**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së Matematikë, Fizikë dhe Tik me 19 orë, pushim i lehonisë deri me 06.01.2021, plotësim norme në Gjimnazin "Xhavit Ahmeti" dhe SHFMU "Nazim Hikmet" paralelet me mësim në gjuhën Turke.
- II. Shkolla e Mesme e Lartë (SHML)**
- SHMLE "Marin Barleti" në Gjiçan**
 - Një mësimdhënës/e i lëndës së TIK-ut, me 16 orë, në kohë të caktuar deri me 31.08.2021
 - SHMLM "Dr. Asllan Elezi" në Gjiçan**
 - Një mësimdhënës/e për lëndë mjekësore, me 10 orë me kohë të caktuar deri me 31.08.2021
 - SHMGjinnazi "Zenel Hajdini" në Gjiçan**

- Një mësimdhënës/e i lëndës së artit , pushim i lehonisë deri më 31.03.2021
- 4.SHML e Muzikës**
- Një mësimdhënës/e i lëndës së Pianos, me 10 orë me kohë të caktuar deri me 31.03.2021

Vërejtje: Kontratat e punës përveç atyre që janë pushim i lehonisë dhe pushim pa pagesë lëshohen deri më 31.08.2021. Pas skadimit të këtyre kontratave që lëshohen deri me 31.08.2021 për këto vende të punës, Drejtoria Komunale e Arsimit në cilësinë e punëdhënësit do të bëjë një analizë të tepricave të mësimdhënësve që mund të ketë për vitin shkollor 2021/2022, në rast se nuk paraqiten teprica të mësimdhënësve, nëpunësve të pranuar do t'u vazhdohet kontrata e punës në ato shkolla.

Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit para universitar dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT (UA Nr.10/2018) ,Udhëzimin Administrativ MASHT, nr.05/2015 Normativit për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional si dhe procedurave të përcaktuara për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Kualifikimi për Edukatorë/e dhe Mësimdhënës/e: kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit të MASHT-it në fuqi. Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me udhëzimin administrativ të MASHT-it, nr. 12/2018, në të kundërtën komisioni gjatë selektimit të aplikacioneve, do të refuzoj çdo aplikacion të kandidatëve të cilët nuk e kanë plotësuar këtë kusht të konkursit.

Për vendet e punës në fjalë nevojiten këto dokumente: diploma mbi përgatitjen profesionale, kopja e letërnjoftimit, vërtetim mbi përvojën e punës, certifikatën e lëshuar nga sektori gjendjes civile me të cilin dëshmohet vendbanimi i kandidatit, vërtetimi nga gjykata kompetente se personi nuk është nën hetime. Të gjitha duhen të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga shpallja në gazeta zyrtare dhe në mjetet e tjera të informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më 04.11.2020 deri më datë 18.11.2020(ora: 16:00).

Komisioni do të bëjë selektim të aplikacioneve dhe në intervistë ftohen vetëm ata kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e konkursit dhe në pajtim me normativet në fuqi. Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Të gjithë kandidatët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbim të Qytetarëve në Gjiçan. Kandidatët të cilët aplikojnë më shumë se një shkollë, mund të aplikojnë vetëm me një formularë të aplikimit duke i cekur emrat e shkollave ku aplikon.

Sqarim:

Për këto vende të punës, kandidatët duhet t'i nënshtrohen testit me shkrim. Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në objektin pranë Qendrës për Shërbim të Qytetar.

Vërejtje: Për shkak të rrethanave të Pandemisë – Covid 19, Testi me shkrim dhe Intervista me gojë do të realizohen sipas Rekomandimeve dhe Udhëzimeve të IKSH (Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik) dhe MSH (Ministritë së Shëndetësisë).

Drejtori:
Nazim Gagica

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

"Lemon Tree Italia" Sh.p.k, me numër UNIK Identifikues: 810711011 dhe me numër fiskal: 600779998 si dhe me numër të Biznesit: 70829428 me seli në Suhodoll, magjistralla Prishtinë – Lipjan, shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit dhe numrin fiskal.

► Luan Binaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Avdyll Frasher " Prizren.

► Albert Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - V dhe VI - IX shf " Bajram Curri " Krushë e Madhe

► Selami Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

► Adis Morina shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Selami Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

